



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 07.12.2022

Nr: 225

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

KODIFIKIMIN E MATERIALEVE DHE DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR

Në mbështetje të neneve 12, pikat 1 dhe 2, dhe 19 pikat 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Materialet dhe dokumentacioni zgjedhor kodifikohen sipas një sistemi unik të kodifikimit.
2. Kodi unik për çdonjërin nga materialet apo dokumentacionin zgjedhor përbëhet nga shkronjat “KQZ” të ndjekura nga dy çifte numrash të ndarë nga njëri-tjetri me shenjën ndarëse “-“. Çifti i parë i numrave tregon kategorinë e materialit apo dokumentacionit zgjedhor. Çifti i dytë i numrave tregon numrin e materialit apo dokumentacionit zgjedhor. Shembulli i formatit të kodit i përcaktuar sipas kësaj pike, pasqyrohet në shtojcën 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Materialet dhe dokumentacioni zgjedhor ndahen në kategori të ndryshme sikurse përcaktohet në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Krijohet Regjistri i Materialeve dhe Dokumentacionit Zgjedhor. Regjistri përmban kodin unik të ndarë sipas fushave përbërëse të tij, numri i kategorisë dhe numri i materialit, apo dokumentacioni zgjedhor, si dhe përshkrimin e këtyre të fundit.
5. Regjistri i Materialeve dhe Dokumentacionit Zgjedhor miratohet, mbahet dhe përditësohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Regjistri mbahet në formatin “print”, si dhe në atë elektronik. Një kopje e njësuar e formatit “print” depozitohet në fund të çdo viti në protokollin e KQZ.



6. Caktimi i kodit unik për çdo material apo dokumentacion zgjedhor bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ sipas rekomandimeve të stafit përkatës, sipas rastit.
7. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e dekretimit të zgjedhjeve, apo 48 (dyzet e tetë) orë nga data e dekretimit të zgjedhjeve të pjeshme/parakohshme, Sekretari i Përgjithshëm përcakton sasi të materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor që do t'u dërgohen komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor (KZAZ), komisioneve të qendrave të votimit (KQV) dhe grupeve të numërimit të votave (VNV), sipas kodit unik dhe emërimit.
8. Ngarkohen administrata e KQZ-së dhe Sekretari i Përgjithshëm për kodifikimin e materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Shembulli i formatit të kodit

KATEGORIA 00 - Procesverbale

KQZ-00-01 Për pajisjen e KZAZ me materiale për administrimin e zgjedhjeve

KQZ-00-02 Për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për procesin e numërimit të
votave

.....

KATEGORIA 01 - Vendime

KQZ-01-01 Për propozimin e kryetarit të KZAZ

KQZ-01-02 Për propozimin e zëvendëskryetarit të KZAZ

.....

Kategoritë e materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor:

Kategoria - Procesverbale

Kategoria - Vendime

Kategoria – Regjistra

Kategoria – Raporte

Kategoria – Formularë

Kategoria – Vërtetime

Kategoria – Pyetësorë

Kategoria – Udhëzues

Kategoria – Zarfe

Kategoria – Shenja dalluese

Kategoria – Fletë votimi

Kategoria - Kuti

Kategoria – Postera dhe fletëpalosje

Kategoria – Dosje

Kategoria – Materiale votimi

Kategoria – Materiale të tjera

Kategoria – Materiale sigurie

Kategoria – Pajisje elektronike